



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

---

Numri i lëndës: 2019:097411

Datë: 05.01.2021

Numri i dokumentit: 01387637

**P.nr.102/14**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues Bekim Veliqi, me anëtarët e trupit gjykues-gjyqtarët Rrahman Beqiri dhe Dragica Jakovljeviq, me procesmbajtësin Endrit Hajrizaj, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.P nga Mitrovica për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së e rikualifikuar në veprën penale Posedimi i i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së dhe Sh.S nga Mitrovica për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së e rikualifikuar në veprën penale Posedimi i i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.nr.34/2014 e dt.27.08.2014, e përfaqësuar nga Prokurori i Shtetit Fetije Bajrami Shala, në prezencë të të akuzuarve B.P dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av. Bedri Miftari si dhe të akuzuarit Sh.S dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av.Agim Lushta, pas mbajtjes të seancës së shqyrtimit gjyqësor në bazë të nenit 359, 360, 361, 362, 363 par.1 nën par.1.3 të KPP-së, me dt.09.12.2020, është marrë dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.05.01.2021:

**A K T G J Y K I M**

**I. I akuzuari: B.P**, nga i ati R., e ëma F., e gjinisë F., i lindur me dt.... në Mitrovicë, me nr. personal ..., me vendbanim në rr.“...” Mitrovicë, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike nën asistencë sociale, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, nën masën e paraburgimit nga dt.13.02.2014 deri me dt.28.03.2014 dhe nën masën e arrestit shtëpiak 28.03.2014 deri me dt.28.04.2014.

Në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPP-së merr këtë:

**REFUZOHET AKUZA**

**SEPSE:** Me dt.13.02.2014 rreth orës 21:50 min., afër ish “Barnatores së Shtetit”, në Mitrovicë, ka poseduar pa autorizim substanca narkotike të llojit Kanabis Marihuanë, ku pas kontrollit nga ana e Policisë, në xhepin e jaknës i kanë gjetur dhe sekuestruar një paketim të mbështjellur me qese të najlonit, substancën narkotike-marihuanë sipas raportit të ekspertizës së dhëna nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë është konstatuar se substanca përmbanë Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë prej 1.67 gram.

**Me këtë kishte për të kryer veprën penale Posedimi i i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.**

**II. I akuzuari: SH.S**, nga i ati H., e ëma N., e gjinisë T., i lindur me dt... në Vushtrri, me vendbanim në rr.“...” i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën filllore, i gjendjes së dobët ekonomike, Ashkali, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPP-së merr këtë:

### **REFUZOHET AKUZA**

**SEPSE:** Me dt.13.02.2014 rreth orës 21:50 min., në Parkun e Qytetit në Mitrovicë, derisa sa ishte me dëshmitarët A.S dhe L.Xh, ka poseduar pa autorizim substanca narkotike të llojit Kanabis Marihuanë, ku pas kontrollit nga ana e Policisë tek i pakuzuari është gjetur dhe sekuestruar një qese e najlonit e cila përmbante substancë narkotike Kanabis Marihuanë me pesh 0.71 gram si dhe një cigare me substancë narkotike Kanabis Marihuanë me peshe 0.78 gram., këto të konstatuar sipas raportit të ekspertizës së dhënë nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë është konstatuar se substanca përmban Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC).

**Me këtë kishte për të kryer veprën penale Posedimi i i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.**

**III.** Në mbështetje të nenit 275 par.3 të KPRK-së ku përcakton se “substancat narkotike, substancat psikotrope ose analoge konfiskohen” e lidhur me neni 282 par.1 ku përcakton se “pasuria që është qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, pa marrë parasysh gjetjet e gjyqtarit të vetëm gjykues ose trupit gjykues lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit” lidhur me par.2 nën par.2.4 të KPP-së ku përcakton se “kimikatet, fabrikat, paisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga neni 272-280 të Kodit Penal”, nga i akuzuari **Sh.S KONFISKOHET** substanca narkotike Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me pesh neto 0.71 gram, dhe një cigare me përmbajtje Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me pesh neto 0.78 gram, nga i akuzuari **B.P KONFISKOHET** substanca narkotike Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me pesh neto 1.67 gram, (sipas Raportit të Ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me nr. ref.AKF/2014-1381/2014-1114 i dt.08.05.2014), substancat narkotike pas plotëfuqishmërisësë këtij aktgjykimi të shkatërrohen në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**IV.** Të akuzuarit të lirohen nga shpenzimet e procedurës duke u bazuar në nenin 454 par.1 të KPP-së, ku përcakton se “kur pushohet procedura penale apo kurr merret aktgjykimi me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza gjykata me aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 450 par.2 nën par.2.1 të, deri 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të akuzuarit dhe kompezimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore”.

### **A r s y e t i m i**

#### **Aktakuza**

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.34/2014 e dt.27.08.2014 kundër të akuzuarve B.P nga Mitrovica për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së dhe Sh.S nga Mitrovica për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së.

## **Rrjedha e procedurës**

### **Shqyrtimi fillestar**

Me dt.16.12.2019, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ka prezentuar i akuzuari B.P dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Bedri Miftari, ka prezentuar i akuzuari Sh.S dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Agim Lushta, ka prezentuar Prokurori i Shtetit Fetije Bajrami Shala, në seancën e shqyrtimit fillestar të akuzuarit janë deklaruar mbi fajësinë, nuk e kanë pranuar fajësinë në lidhje me veprën penale për të cilën janë akuzuar sipas aktakuzës, ndërsa brenda afatit të përcaktuar, të akuzuarit kanë paraqitur kundërshtime ndaj aktakuzës përmes mbrojtësve të tyre.

Gjykata sipas Aktvendimit P.nr.102/14 të dt.16.01.2020, ka refuzuar kundërshtimet e mbrojtësve, ndaj këtij Aktvendimi, mbrojtësi i të akuzuarit Sh.S, av.Agim Lushta ka paraqitur ankesë brenda afatit të përcaktuar ligjor, Gjykata e Apelit sipas Aktvendimit P.nr.102/14 të dt.03.03.2020, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit dhe Aktvendimi P.nr.102/14 i dt.16.01.2020, është bërë i formës së prerë.

### **Shqyrtimi gjyqësor**

Me dt.21.10.2020, dt.23.11.2020 dhe dt.08.12.2020, janë mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, seancat kanë qenë të hapura në respektim të masave anti COVID-19.

### **Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor**

Në cilësi të provës janë administruar provat e propozuara nga Prokuroria e Shtetit në PTH në Mitrovicë.

Prokuroria në Aktakuzë ka propozuar që në cilësinë e dëshmitarëve të dëgjohen dëshmitarët L.Xh dhe A.S, Gjykata ka provuar që të njëjtit t'i ftoj me ftesa të rregullta mirëpo nga fletëkthesat e gjykatës është konstatuar se dëshmitari L.Xh është palë e panjohur ndërsa dëshmitari A.S gjinden jashtë vendit. Në raport me dëshmitarët, Gjykata ka lëshuar Urdhëresës për shoqërimin me forcë, nga Raporti përmes email-it i Policisë-Stacioni Policor në Pejë i dt.21.10.2020, e ka njoftuar Gjykatën se kanë vepruar sipas urdhëresës së Gjykatës, dëshmitari L.Xh nuk është hasur në adresën e dhënë dhe i njëjti në komunitet është person i panjohur, kurse nga Raporti Policor me shkrim -Stacioni Policor në Mitrovicë i dt.20.10.2020, të njëjtit e kanë njoftuar Gjykatën se kanë vepruar sipas urdhëresës, kanë shkuar në shtëpinë e dëshmitarit A.S dhe nga babai i tij H. kanë marrë informacion se dëshmitari A.S që rreth 6 vite nuk jeton në Kosovë dhe sipas babait të tij ai ndodhet në shtetin e Gjermanisë pa të dhëna për adresën e vendqëndrimit.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.08.12.2020, Prokurori i Shtetit ka propozuar që të lexohen deklaratat e dëshmitarit A.S dhënë në Prokurori me dt.28.03.2014 dhe në Polici me dt.14.02.2014, si dhe deklarata e dëshmitarit L.Xh e dhënë në polici me dt.14.02.2014.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.P, av.Bedri Miftari ka deklaruar se e kundërshtoj leximin e deklaratës së dëshmitarit A.S po ashtu e kundërshtoj deklaratat e tjera të dëshmitarëve në raport me të mbrojturin tim.

I akuzuari B.P ka deklaruar se e kundërshtoj që të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.S, av.Agim Lushta ka deklaruar se duke u nisur nga fakti se dëshmitarët janë të pararitshëm unë nuk kam kundërshtime në leximin e deklaratave të tyre dhe nuk kam kundërshtime ndaj atyre provave.

I akuzuarit Sh.S ka deklaruar se nuk e kundërshtoj leximin e deklaratave të dëshmitarëve.

Trupi gjykues e ka aprovuar propozimin e Prokurorit të Shtetit, që të lexohen deklarata e dëshmitarit L.Xh e dhënë në Polici me dt.14.02.2014 si dhe deklarata e dëshmitarit A.S e dhënë në Prokurori me dt.28.03.2014 si dhe deklarata e dhënë në Polici me dt.14.02.2014, duke u bazuar në nenin 338 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, ku përcakton se “Përveç rasteve të parapara me këtë Kod, procesverbalet mbi deklaratimet e dëshmitarëve, të bashkakuarve ose pjesëmarrësve të dënuar për vepër penale, si dhe procesverbalet dhe shkresat tjera mbi konstatimin dhe mendimin e ekspertit, sipas vendimit të trupit gjykues mund të lexohen vetëm në këto raste” ... “kur personat e marrë në pyetje kanë vdekur, kanë çrregullime ose paaftësi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose shkaqeve të tjera të rëndësishme”.

Gjykata këtë vendim e kam mbështetur në faktin se dëshmitarët e propozuar nga ana e Prokurorisë nuk ka qenë e mundur që të gjenden dhe se Gjykata ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore të përcaktuara si më lart në këtë aktgjykim lidhur me sigurimin e prezencës së tyre në seancë mirëpo prapë të njëjtit nuk ka qenë e mundur që të sigurohet prezenca e tyre në procedurë penale, po ashtu Gjykata ka vlerësuar faktin se deklaratat e dëshmitarëve të marra në Prokurori dhe në Polici janë marrë në përputhje me dispozitat e procedurës penale.

#### **Administrimi i provave materiale**

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 08.12.2020 provat që janë administruar në cilësinë e provave materiale janë këto:

- Ekspertiza e Njesisë së Shkencave ligjore, Analiza Kimike-Raporti i Ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr.AKF/2014-1381/2014-1114 e dt.08.05.2014.
- Vërtetimit mbi konfiskimin me nr.2014-DHTN-053 i dt.13.02.2014 (Sh.S).
- Vërtetimet mbi konfiskimin me nr.2014-DHTN-053 i dt.13.02.2014 (B.P).
- Fotodokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës.
- Raporti i Policor i dt.14.02.2014.

Ashtu siç konstatohet në procesverbalin e seancës Prokurori i Shtetit, mbrojtësit dhe të akuzuarit nuk kanë pasur propozime për plotësimin e procedurës së provave.

#### **Marrja në pyetje e të akuzuarve**

Me 08.12.2020 në seancën e shqyrtimit gjyqësor i akuzuari B.P është njoftuar me të drejtat e tij ligjore që i përkasin në bazë të nenit 323 dhe nenit 346 të KPP-së, i njëjti pas konsultimit me mbrojtësin e tij është deklaruar lidhur me çështjen.

I akuzuari në mbrojtjen e tij të paraqitur në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ka punuar kamarier në një restaurant “T.” në atë kohë ndërsa ditën kritike ka qenë në barnatoren e shtetit për t’i blerë barna shefit të tij, kur ka dalur jashtë e kanë ndalur policia, e kanë pyetur nëse ka diçka të paligjshme me veti dhe se i njëjti ka thënë po dhe vullnetarisht i ka dorëzuar policisë një qese me marihuanë (me peshë 1.67 gram), substancën narkotike e ka marrë nga i akuzuari Sh., kur e ka takuar tek parku i qytetit, ka blerë marihuanë disa herë nga i akuzuari Sh., natën kritike është takuar me të akuzuarin Sh. tek vendi ku ka punuar restoranti “T.” dhe aty e ka blerë marihuanën, numrin e telefonit ja ka dhënë të akuzuarit Sh. me qëllim që kur i njëjti të ketë marihuanë ta thërras, natën kritike i akuzuari Sh. e ka thirrur në telefon mirëpo nuk ja ka hapur telefonin, nuk merrem me shitjen e narkotikëve, kam qenë përdorues i tyre mirëpo tani nuk e përdori, ashtu siç konstatohet në procesverbalin e seancës.

Me 08.12.2020 në seancën e shqyrtimit gjyqësor i akuzuari Sh.S është njoftuar me të drejtat e tij ligjore që i përkasin në bazë të nenit 323 dhe nenit 346 të KPP-së, i njëjti pas konsultimit me mbrojtësin e tij është deklaruar se do të mbrohet në heshtje lidhur me çështjen dhe se qëndron

pranë deklaratave të dhëna në polici dhe në Prokurori. Trupi gjykues ka konstatuar se mbrojtja në heshtje është mundësi ligjore e përcaktuar me nenin 346 dhe nenin 323 të KPP-së.

### **Fjala përfundimtare**

Me dt.08.12.2020, Prokurori i Shtetit, mbrojtësit dhe të akuzuarit kanë paraqitur fjalën përfundimtare direkt në procesverbalin e seancës së shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar “mbesë në tërësi pranë aktakuzes ndaj të akuzuarve B.P dhe Sh.S dhe atë, për të akuzuarin B.P për shkak të veprës penale Blejra, posedimi, shpërndarja dhe shitja e narkotikëve, psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së ndërsa sa për të akuzuarin Sh.S për veprën penale Blejra, posedimi, shpërndarja dhe shitja e narkotikëve, psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, e që vërtetohet edhe nga shkresat të tjera që të akuzuarit kanë kryer veprat penale, nga raporti i policisë i dt.13.02.2014, ku policia në natën kritike ka ndaluar të akuzuarin Sh.S dhe dëshmitarët A.S dhe L.Xh ku tek i akuzuari **Sh. i është gjetur një sasi e marihunës dhe një cigare e mbështjellur** dhe i njëjti pranë policisë ka deklaruar se substancën narkotike e ka blerë nga një person që punon në kamarier që punon tek “T.” i pandeuhri Sh. ka bashkepunuar me policinë ku i akuzuari Sh. e ka thirr në telefon të akuzuarin B., ku i akuzuari B. ka dalu nga kafeneja dhe e ka pëcjellur policia, ku është ndaluar nga policia dhe tek i njëjti është gjetur sasi e marihunës ku edhe nga vëtetimet mbi konfiksion vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprat penale, po ashtu nga deklarata e dëshmitarit A.S dhënë në polici ku deklaroi se atë natë rreth prës 21:40 i ka thirr në telefon tani i akuzuari B.P i cili ka punuar në kafenen “T.” dhe afër “R. B.” i ka dhënë një “pesqëshe”-qese me narkotike ku menjëherë pas blerjes i ka ndaluar policia, dhe ku dëshmitari deklaroi se nga ky i akuzuari nuk është hera e parë që kemi blerë marihuanë por edhe hera të tjera ku i njëjti i jep numrin e telefonit të të akuzuarit B. dhe atë policisë numrin ..., njëjtë deklaroi edhe dëshmitari L.Xh, se atë natë kanë shkuar afër “R. B.” me të akuzuarin Sh. dhe dëshmitarin A., ka ardhur një person dhe i ka jep diçka në dorë Sh., pastaj kanë shkuar në parkë të qytetit dhe i ka nxënë policia, i njëjti deklaroi se edhe tri herë më herët kam blerë marihuanë nga ky person, dhe i njëjti ja jep numrin e telefonit policisë dhe atë numrin e telefonit të akuzuarit B. ... dhe thekson se i akuzuari Sh. atë natë tek ky numër e ka porositur marihuanën, njëjtë deklaroi dhe i akuzuari Sh. ku që të tre deklarojnë njëjtë po atë natë që janë ndaluar tek policia, ku i pandeuri Sh. deklaroi njëjtë, dhe pas kontrollimit nga ana e policisë tek i njëjti është gjeut narkotiku, i akuzuari Sh. deklaroi po ashtu njëjtë si dëshmitarët se substancën e ka marrë tek një person që punon kamarier tek kafeneja “T.” dhe deklaroi se ka paguar 5 euro, i njëjti deklaroi se është njoftuar me të akuzuarin B. pranë kafenesë “T.” dhe i akuzuari B. i ka ofruar marihuanën dhe i ka dhënë edhe numrin e tij të telefonit ..., dhe se atë natë e ka thirr në telefon, ndërsa i akuzuari B.P në deklaratën e dhënë në polici, pranon se policia gjatë bastisjes atë natë në gjepin e jaknes së tij kanë gjetur një sasi të marihuanës, të cilën thekson se e ka pasur për posedim personal, i njëjti deklaroi se nuk e njeh me emër të akuzuarin Sh.S dhe mohon të ketë kontaktuar atë natën me ndonjë person lidhur me marihuanën dhe e jep numrin e tij të telefoni ..., thekson se të njëjtën e ka blerë nga disa persona ashkali, në shumë prej 5 euro duke thënë se i ka takuar tek parku i qytetit, marihuanën ka deklaruar se e përdor që 3 vite, dhe i njëjti deklaroi se përveq Sh.it kam blerë edhe nga persona të tjerë, kështu njëjtë ka deklaruar edhe në deklaratën në prokurori dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, andaj duke u bazuar në gjithë këto prova, deklaratat e dëshmitarëve, vëretimet mbi konfiskimin e sendeve, fotodokumentacionin në shkresat e lëndës, dhe ekspertizën e narkotikëve, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtit ti shpallë fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit duke marrë parasysh rrethanat lehtësues dhe rënduese të parapara me ligj.”

Mbrojtësi i të akuzuarit B.P, av.Bedri Miftari në fjalën përfundimtare ka deklaruar: me qenë se është një fjalë latine që thotë “drejtësia e vonuar nuk është drejtësi” me qenë se kanë kaluar afër 7 vite nga ky rast, dhe nga deklaratimet e të mbrojturit tim mendoj që e kemi arritur të

vërtetën, ku i mbrojturi im është deklaruar në seancë dhe nga deklaratimet e tij në polici, u pa qartë se si ka rrjedhur kjo ngjarje, andaj kërkoj nga gjykata që me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ti ketë parasysh edhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese pasi që tash i mbrojturi im është bërë prind, është duke punuar dhe që nga ajo ditë më nuk ka rënë ndesh me ligjin.

I akuzuari B.P në fjalën përfundimtare ka deklaruar: qëndroj pranë fjalës përfundimtare të mbrojtësit tim.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.S, av.Agim Lushta në fjalën përfundimtare ka deklaruar: është fakt se në shqyrtimin e sotëm është vërtetuar nga deklaratimet e dy dëshimtarëve, L.Xh dhe A.S të cilat vërtetojnë faktin se të njëjtit kanë marrë dhe blerë marihuanë nga i akuzuari B.P, duke pasur parasysh se deklaratimet e të bashkakuzuarve nuk janë prova të pranueshme për të akuzuarin tjetër lidhur me nein 262 të KPP-së ku gjykata nuk mund ta shpallë fajtor të akuzuarin duke u bazuar vetëm një dëshmi, konsideroj se vepra penale me të cilën prokuroria e ngarkton të mbrojturin tim është e paqëndrueshme ndërsa sa i përket veprës penale Posedim i naroktikëve nga neni 275 i KPRK-së duke pasur parasysh provat konsideroj se e njëjta qëndron mirëpo duke pasur parasysh afatin e parashkrimit absolut të veprës penale i propozoj gjykatës që këtë vepër ta hudh poshtë.

I akuzuari Sh.S në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e mbështes deklaratimin e mbrojtësit tim.

### **Përfundimi i shqyrtimit gjyqësor**

Më datë 08.12.2020, trupë gjykues e ka shpallur të përfunduar shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale.

### **Shpallja publike e aktgjykimit**

Më datë 09.12.2020 gjykata e ka shpallur publikisht aktgjykimin në prezencën e të akuzuarve ndërsa në mungesë të mbrojtësve dhe të Prokurorit të Shtetit.

## **GJETJET E GJYKATËS NË RAPORT ME RRETHANAT E GJENDJES FAKTIKE**

### **Faktet jokontestuese**

#### **Faktet në vijim nuk kanë qenë kontestuese:**

- Tek i akuzuari B.P është gjetur substancë e dyshuar narkotike e mbështjellur në qese najlloni.
- Pas ekzaminimit laboratorik të substancës është konstatuar se kjo substancë përmbanë substancë naroktike Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol me pesh neto 1.67 gram.
- Tek i akuzuari Sh.S është gjetur substancë e dyshuar narkotike e mbështjellur në qese najlloni si dhe një cigare e mbështjellur e dyshuar me substancë narkotike.
- Pas ekzaminimit laboratorik të substancës në qese dhe cigarës së mbështjellur është konstatuar se substanca në qese përmbanë substancë naroktike Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol me pesh neto 0.71 gram si dhe cigarja e mbështjellur përmbanë substancë naroktike Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol me pesh neto 0.78 gram.
- Numri i telefonit ... ka qenë numri i telefonit të të akuzuarit B.P.

Bazuar në provat që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor gjegjësisht nga Fotodokumentacioni, Ekspertiza e Njësisë së Shkencave ligjore, Analiza Kimike-Raporti i Ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr.AKF/2014-1381/2014-1114 e

dt.08.05.2014, raporti i Oficerit Policor i dt.14.02.2014, që gjenden në shkresat e lëndës faktet e lart cekura nuk janë të kontestuara.

Nga Fotodokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës shihet vendi ku është gjetur substanca narkotike tek i akuzuari Sh.S si dhe substanca narkotike së bashku me cigaren e mbështjellur po ashtu shihet substanca narkotike e gjetur tek i akuzuari B.P.

Në Raportin e Oficerit Policor i dt.14.02.2014, specifikohet se i akuzuari Sh.S është takuar nga ana e policisë tek parku i qytetit në Mitrovicë së bashku me dy dëshmitarët A.S (vëllau i të akuzuarit Sh.) dhe L.Xh, ku tek i akuzuari Sh.S është gjetur substanca narkotike dhe cigarja e mbështjellur, po ashtu në raport ceket se i akuzuari B.P është ndaluar nga ana e policisë tek “Barnatorja e Shtetit” dhe se tek i njëjti është gjetur një qese me substancë narkotike.

Nga Ekspertiza e Njesisë së Shkencave ligjore, Analiza Kimike-Raporti i Ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr.AKF/2014-1381/2014-1114 e dt.08.05.2014 vërteton faktin se substancat e gjetura tek të akuzuarit përmbajnë substancë narkotike Kanabis Marihuanë me specifikat e cekura si më lart në këtë Aktgjykim.

Për Gjykatën, faktet e lart cekura nuk ishin kontestuar nga Prokurori i Shtetit, të akuzuarit dhe as nga mbrojtësit, përveç kësaj këto fakte vërtetohen edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor që janë pjesë e kësaj lënde.

### **Në këtë çështje penale kontestues ka qenë fakti se i akuzuari B.P a i ka shitur substancën narkotike të akuzuarit Sh.S?**

I akuzuari B.P ka mohuar veprën penale dhe pretendimet e prokurorisë, po ashtu edhe i akuzuari Sh.S e ka mohuar veprën penale dhe pretendimet e prokurorisë.

Gjykata vlerëson se Prokuroria në përshkrimin faktik të aktakuzës në pikën I dhe II të dispozitivit të aktakuzës, vetëm ka theksuar veprimet nën dyshimin e pambështetshëm se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen, duke bërë vetëm përshkrimin e deklaratave të dëshmitarëve të dhëna në **Prokurori dhe në Polici** në dispozitivin e aktakuzës.

Në rastin konkret kemi përshkrimin e kryerjes së veprës penale por nuk janë ndërlidhë veprimet inkriminuese të të akuzuarve me përshkrimin faktik si në dispozitivin e aktakuzës dhe nuk janë mbështetë në asnjë provë të bazuar, të besueshme dhe konkrete, **akuza nuk mbështetët me asnjë provë që e vërteton se i akuzuari B.P i ka shitur substanca narkotike të akuzuarit Sh.S**, të gjitha këto vërtetojnë se nuk kemi asnjë element që në veprimet e të akuzuarit B.P konsumohet vepra penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së, dhe se në veprimet e të të akuzuarit Sh.S, nuk kemi elemente se konsumohet vepra penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, e me arsyet të cilat do të paraqiten në vijim të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, në rastin konkret kemi përshkrimin faktik në dispozitiv të aktakuzës, që në dukje do të krijohej përshtypja fillestare se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale që akuzohen nga Prokuroria, mirëpo jo në pajtushmëri me **provat materiale, që në veprimet e të akuzuarve të krijohehen elementet e veprës penal që akuzohen.**

## Vlerësimi i provave

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.08.12.2020 në cilësin e provës është lexuar raporti i policor i dt.14.02.2014. Gjykata ka shqyrtuar këtë raport ku tek i njëjti ceken veprimet e ndërmarra nga ana e zyrtarëve policor në lidhje me kryerjen e detyrave të përcaktuara sipas ligjit, në këtë raport përmendet se zyrtarët policor i kanë ndaluar personat Sh.S, A.S dhe L.Xh tek Parku i Qytetit në Mitrovicë, ku pas kontrollit të të njëjtëve tek Sh.S kanë gjetur substancë narkotike në një qese dhe një cigare të mbështjellur me marihuanë, të njëjtit e kanë pyetur të akuzuarin Sh. se ku e ka blerë substancë, i njëjti j'u ka thënë policise se e ka blerë nga një person që punon si kamarier tek restoranti "T.", dhe se nga ai më parë po ashtu kishte blerë substanca narkotike, i njëjti ka shprehur gatishmërinë që të bashkpunojë me policinë duke i treguar vendin se ku punon personi që pretendon se ka blerë marihuanë nga ai, policia kanë shkuar afër restorantit "T." duke theksuar se i akuzuari Sh. e ka thirru personin që ka punuar tek "T." ku i njëjti ka dalur nga restoranti dhe policia e kanë përcjellur në drejtim të ish "Barnatores së Shtetit" ku dhe e kanë ndaluar përballë saj, aty e kanë vërejtur se bëhet fjalë për personin-tani të akuzuarin B.P, dhe në xhepin e tij të jaknes i kanë gjetur një sasi të marihuanës në qese.

Gjykata thekson faktin se bazuar në raportin e policor i dt.14.02.2014, të cilin Gjykata e ka adiminstruar në cilësinë e provës gjatë shqyrtimit të provave, nuk mund të arrihet që të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar si në aktakuzë nga ana e Prokurorisë. Gjykata thekson faktin se i njëjti më shumë vërteton faktin se tek të akuzuarit me veprimet e tyre inkriminuese të përshkruara në këtë raport dhe disa prej tyre të përshkruara në aktakuzë i përmbushin-krijojnë elementet e veprës penale të rikualifikuar nga ana e gjykatës dhe atë veprës penale Posedimi i i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, organet e ndjekjes kanë pasur mundësi ligjore për ndërmarrjen e veprimeve siç parashihen me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale nëse në veprimet e të akuzuarit ka elemete të veprës penale nga neni 273 të KPRK-së, duke zbatuar masat e fshehat teknike të hetimit dhe vëzhgimit, por nuk janë ndërmarrë këto veprime andaj gjykata duke pasur parasysh këto rrethana nuk ka mundur të vërtetoj se në veprimet e të akuzuarve janë përmbushur elementet e veprës penale nga neni 273 të KPRK-së.

Fillimisht Gjykata thekson faktin se bazuar në Raportin e Policor i dt.14.02.2014, vendi i ngjarjes-kryerjes së veprës penale nuk përputhet me vendin e ngjarjes në dispozitivin e aktakuzës, fillimisht në raport ceket se i akuzuari Sh.S së bashku me dëshmitarët A.S dhe L.Xh janë ndaluar nga ana e Policisë tek "Parku i Qytetit" në Mitrovicë dhe po ashtu ceket se i akuzuari B.P është ndaluar nga ana e Policisë tek ish "Barnatorja e Shtetit" në Mitrovicë, ndërsa Prokuroria në dispozitivin e aktakuzës në pikën I dhe II thekson se vendi i kryerjes së veprës penale ka qenë afër "R.B" në Mitrovicë. Gjykata vlerëson se prova si e tillë është në kundërtënjë me aktakuzën bazuar në përshkrimin e veprimeve ligjore të ndërmarra nga ana e zyrtarëve policor-përshkrimin të tyre në këtë raport dhe përshkrimin të dispozitivit të aktakuzës. Për Gjykatën nuk mund të qëndroj fakti se vendi i kryerjes së veprës penale si në pikën I të dispozitivit të aktakuzës për të cilën akuzohet B.P është "afër R.B në Mitrovicë", kjo pasi që bazuar në raportin policor vendi i ndalimit të akuzuarit B.P ka qenë tek ish "Barnatorja e Shtetit", po ashtu nuk mund të qëndroj fakti se vendi i kryerjes së veprës penale si në pikën II të dispozitivit të aktakuzës për të cilën akuzohet Sh.S është "afër R.B në Mitrovicë", pasi që i njëjti është ndaluar nga ana e Policisë së bashku me dëshmitarët A.S dhe L.Xh tek "Parku i Qytetit" në Mitrovicë.

Gjykata thekson se duke u bazuar në provën e lart cekur e cila është adiminstruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, nuk mund të arrij në përfundimin e vërtetimit përtej dyshimit të bazuar se veprimet inkriminuese nga ana e të akuzuarve përmbushin-konsumojnë elementet e veprës



penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së apo veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së, kjo për disa arsye që do të theksohen më poshtë.

Për Gjykatën, nuk është kontestues fakti se tek i akuzuari B.P dhe tek i akuzuari Sh.S që është gjetur substancë narkotike, për më tepër kjo vërtetohet edhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, mirëpo është kontestues **“shitja dhe shpërndarja”** që ndërlidhet me kualifikimin e veprave penale të bëra nga ana e Prokurorisë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, për përmbushjen e elementeve dhe figurës së veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së, duhet që substancën narkotike i akuzuari **“ta shet ose shpërndan”**, dhe në rast të mos përmbushjes së këtij elementin nuk kemi të bëjmë me këtë vepër penale.

Më rastin e përmbushjes së elementeve të kësaj vepre penale duhet që të dihet vendi, koha, shitës, blerësi, mënyra e shitjes, fakte këto që do të mund të vërtetoheshin me prova konkrete të marrë sipas procedurave (masave) të parapara ligjore.

Prokuroria në pikën I të dispozitivit të aktakuzës vetëm ka konstatuar përshkrimin se i akuzuari B.P “pa autorizim ka shitur substanca narkotike” duke mos e mbështetur këtë fakt-veprim të pretenduar inkriminues më asnjë provë të vetëm konkrete që do të tregonte se i njëjti është hasur duke e shitur apo shpërndarë substancën narkotike “afër R.B në Mitrovicë” pasi që siç e ka theksuar gjykata edhe më lart në këtë aktgjykim që fillimisht nuk përputhet vendi i kryerjes së veprës penale-ndalimit të të akuzuarit B.P nga ana e Policisë e aq më pak fakti se i akuzuari ditën kritike ka qenë “afër R.B në Mitrovicë” dhe i ka shitur substancë narkotike të akuzuarit Sh.S. Faktin e tillë Prokuroria është dashur që ta mbështes me prova konkrete pasi që është detyrë e Prokurorisë që të kryej hetimet dhe të bëjë mbledhjen e provave dhe jo vetëm në aktakuzë të përshkruaj vendin e ngjarjes dhe veprimet inkriminuese të pretenduara duke i mos bazuar ato në asnjë provë të vetme të marrë sipas procedurave (masave) ligjore të parapara me dispozitat ligjore.

Sa i përket veprimeve inkriminues të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së si në pikën II të dispozitivit të aktakuzës, për të cilat akuzohet Sh.S, Gjykata vlerëson se veprimet e pretenduara inkriminuese të të akuzuarit të përshkruara në aktakuzës janë në kundërtë me vet provat në shkresat e lëndës që janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, kjo për faktin se duke u bazuar fillimisht në Raportin e Oficerit Policor i dt.14.02.2014, nuk përmendet askund që i akuzuari Sh.S është ndaluar nga ana e policisë duke e shpërndarë substancën narkotike tek personat e tjerë, pasi që në raport vetëm theksohet fakti se tek i njëjti është gjetur substanca narkotike së bashku me një cigare të mbështjellur me substancë narkotike pas ndalimit të tij dhe dëshmitarëve A.S dhe L.Xh dhe jo duke e “shpërndarë” atë, si element kyç i veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së. Po ashtu Prokurori ashtu si në pikën I të dispozitivit të aktakuzës edhe në pikën II të saj ka bërë përshkrimin e pretenduar të vendit të ngjarjes pasi si është cekur edhe më lart në këtë aktgjykim i akuzuari Sh.S nuk është hasur nga ana e Policisë “afër R.B në Mitrovicë” duke “blerë substancë narkotike nga i akuzuari B.P” mirëpo **është ndaluar nga ana e Policisë tek “Parku i Qytetit në Mitrovicë”** dhe përshkrimin e veprimeve të pretenduara të veprës penale Prokuroria nuk i ka mbështetur me asnjë provë të vetme, pasi që vet provat e administruara në seancën e shqyrtimit gjyqësor e vërtetojnë faktin se tek i akuzuarit Sh.S është gjetur substancë

narkotike marihuanë e mbështjellur në qese dhe një cigare e mbështjellur me substancë narkotike marihuanë, të cilat janë sekuestruar nga ana e Policisë pas ndalimit të tij në Parkun e Qytetit në Mitrovicë me çka krijohen-përmbushen elementet e veprës penale Posedimi i i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Gjykata, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka lexuar Deklaratën e dëshmitarit L.Xh e dhënë në Polici me dt.14.02.2014 si dhe Deklaratën e dëshmitarit A.S e dhënë në Prokurori me dt.28.03.2014 si dhe Deklaratën e dhënë në Polici me dt.14.02.2014.

Gjykata thekson faktin se dëshmitari A.S është në raporte familjare me të akuzuarin Sh.S, andaj Gjykata duke u bazuar në këtë fakt nuk i fal besimin e plotë deklarates së dëshmitarit A.S dhënë në Prokurori apo në Polici, kjo për faktin se duke pasur parasysh marrëdhëniet në mes të akuzuarit Sh. dhe dëshmitari A. që janë vëllezër të njëjtit kanë mundur që t'i shmangen përgjegjësisë penale të të akuzuarit Sh. duke i bartë përgjegjësinë penale të akuzuarit B.P.

Po ashtu Gjykata nuk i ka falur besimin Deklaratës së dëshmitarit L.Xh e dhënë në Polici me dt.14.02.2014, pasi që Gjykata ka vlerësuar raportet shoqërore të të akuzuarit Sh.S me dëshmitarin L.Xh pasi që të njëjtit kanë qenë shokë dhe po ashtu faktin se tek Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit L.Xh të dhënat e tij nuk janë të plota dhe se Gjykata në bazë të këtyre të dhënave përmes urdhëresës drejtuar Policisë-Stacionit Policor në Pejë ku ceket si vendbanim i dëshmitarit në të dhënat në këtë procesverbal, të njëjtit-Stacioni Policor në Pejë i kanë kthyer përgjigje Gjykatës se personi me të dhënat si në Urdhëresës nuk është i njohur për komunitetin dhe nuk gjindet në vendbanimin e cekur në Urdhëresë, për çka Gjykatës i krijonë një bindje se i njëjti nuk ka dhënë të dhëna të sakta të identitetit të tij pasi që askund në shkresat e lëndës të ofruara nga ana e Prokurorisë nuk kemi ndonjë dokument të identifikimit të dëshmitarit dhe se i njëjti nuk ka dhënë dëshmi të saktë pranë Policisë, andaj gjykata dëshmisë së tillë nuk i fal besimin.

Po ashtu Gjykata thekson faktin se duke u bazuar në nenin 262 par.1 të KPP-së, gjykata të akuzuarin nuk e shpallë fajtor vetëm në bazën e dëshmisë së dëshmitarëve, andaj Gjykata duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e përshkruara si më lart bazuar në deklaratat e dëshmitarëve të lartecur nuk mundi të vërtetoj përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen si në aktakuzës.

Gjykata duke u bazuar në provat e administruara në seancën e shqyrtimit gjyqësor nuk arriti në përfundimin se i akuzuari B.P ditën kritike është ndaluar nga ana e policisë në vendin e pretenduar nga ana e Prokurorisë dhe atë “afër R.B në Mitrovicës” dhe veprimet e pretenduara të Prokurorisë se i njëjti “i ka shitur substancë narkotike të akuzuarit Sh.S” janë veprime të pretenduara nga ana e Prokurorisë që nuk mbështeten në asnjë prove të vetme konkrete.

Bazuar në Raportin Policor i dt.14.02.2014, nuk mund të arrihet të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar së tek veprimet inkriminues të të akuzuarve janë konsumuar elementet e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së dhe të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së pasi që të njëjtit nuk janë hasur nga ana e policisë gjatë shit-blerjes së narkotikëve apo gjatë shpërndarjes së saj si elemente kyçe të kësaj vepre penale.

Pas analizimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, akuzës dhe përshkrimit faktit në pikën I të dispozitivit të akuzës, Gjykata gjenë se përshkrimi faktik dhe veprimet inkriminuese për të cilat dyshohen të akuzuarit të bëra në pikën I dhe II të dispozitivin e akuzës përmbushen

elementet, figura, objekti si dhe veprimet e kryerjes së veprës penale Posedimi i i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së.

Neni 19 par.1 nën par.1.8 i KPP-së përcakton se “Shprehjet e përdorura në kët Kod të Procedurës Penale kanë këto kuptime:” ... **“Dyshim i arsyeshëm** – njohuri për informacionin që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur, po ndodh ose ka mundësi të konsiderueshme që do të ndodhë dhe se personi në fjalë mund të kryejë ose mund të ketë kryer veprën penale. Se çfarë mund të konsiderohet si “e arsyeshme” do të varet nga të gjitha rrethanat.”, ndërsa nën par.1.12 i po të njëjtit nen përcakton se **“Dyshimi i bazuar mirë** – nënkupton ngritjen e aktakuzës. Posedimi i provave të pranueshme që do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i akuzuari.” Gjykata vlerëson se në rastin konkret më shumë kemi pasur të bëjmë me një dyshim të arsyeshëm se të akuzuarit mund të kenë kryer veprat penale se sa me një dyshim të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Sa i përketë dëshmisë që të akuzuarit B.P dhe Sh.S e kanë dhënë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, konkretisht në Polici dhe Prokurori, Gjykata thekson faktin se i akuzuari B.P dhe i akuzuari Sh.S janë në cilësinë e të bashkakuzuarve sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr.34/2014 e dt.27.08.2014, sipas nenit 123 par.5 të KPP-së, që në mënyrë shprehimore përcakton se **“Deklarata e dhënë nga i akuzuari në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të akuzuarit, por jo edhe kundër të bashkakuzuarve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të akuzuarit.”** rrjedhimisht as si provë fajësuese dhe as shfajësuese, që nënkupton se gjykata nuk mund ta mbështes vendimin e saj në deklaratën e të bashkakuzuarve si provë në procedurë dhe në një çështje të njëjtë penale kundër të akuzuarve B.P dhe Sh.S.

Nga kjo nënkuptohet fakti se Gjykata e as Prokuroria nuk mund ta mbështes vendimin e saj në deklaratat e të bashkakuzuarve si provë në procedurën dhe në një çështje të njëjtë penale **në asnjë fazë të procedurës penale.**

Po ashtu Prokuroria në përshkrimin e veprimeve inkriminuese të të akuzuarve në aktakuzë ka përmendur faktin se i akuzuari Sh.S e ka thirrur në telefon të akuzuarin B.P për t'i shitur substanca narkotike, konkretisht në numrin e telefonit të të akuzuarit B.P .... Gjykata, nuk posedon asnjë provë të vetme që e vërteton faktin se të akuzuarit kanë komunikuar mes veti në telefon, Prokuroria është dashur që në rastin e hetimeve dhe mbledhjes së provave të sigurojë prova që e vërtetojnë këtë fakt dhe jo vetëm duke ngriur pretendime të pambështetshme në aktakuzë se “të akuzuarit kanë komunikuar përmes telefonit për shit-blerjen e substancave narkotike”, madje me asnjë provë të vetme nuk mund të vërtetohet ky fakt siç është Listingu i thirrjeve telefonike apo ndonjë provë tjetër që Prokuroria ka mundur që gjatë fazës së hetimeve dhe grumbullimit të provave që ta marrë dhe ta vërtetojë faktin e pretenduar se gjatë periudhës së cekur në dispozitiv të aktakuzës të akuzuarit kanë pasur kontakte telefonike mes vete apo jo dhe jo faktin e tillë kaq të rëndësishëm ta lërë vetëm si pretendim. Po ashtu Prokuroria ka dështuar që ta vërtetojë këtë fakt duke mos siguruar asnjë provë se nga cili numër i telefonik i akuzuarit Sh.S e ka kontaktuar të akuzuarin B.P, pasi siç është theksuar në Aktakuzën e Prokurorisë, ceket vetëm numri i telefonit të të akuzuarit B.P dhe jo edhe numri i telefonit të të akuzuarit Sh.S më anë të së cilit e ka thirrur të akuzuarin B.. Përveç Vërtetimit mbi konfiskimin e sendeve të dt.13.02.2014 ku ceket se nga i akuzuarit B.P është sekuestruara Telefoni Nokia me Sim Kartel me numër ..., Gjykata nuk posedon ndonjë vërtetim tjetër për konfiskimin e ndonjë telefoni nga i akuzuari Sh.S.

Gjykata në raport me vlerësimin e provave të tjera siç janë Ekspertiza e Njesisë së Shkencave ligjore, Analiza Kimike-Raporti i Ekspertizës nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me nr.AKF/2014-1381/2014-1114 e dt.08.05.2014, Vërtetimit mbi konfiskimin me nr.2014-DHTN-053 i dt.13.02.2014 (Sh.S), Vërtetimet mbi konfiskimin me nr.2014-DHTN-053 i dt.13.02.2014 (B.P), Fotodokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, Gjykata provave si të tilla i fal besimin në raport me fuqinë provuese që ato kanë lidhur me veprimet inkriminues të të akuzuarve dhe veprave penale të rikualifikuara nga ana e Gjykatës pasi që të njëjtat vërtetojnë faktin se tek të akuzuarit janë sekuesetruara substanca e dyshuara narkotike dhe se substancat e gjetur janë substanca narkotike, pasi që provat e përmendura vërtetojnë faktet jo kontestuese për Gjykatën të cilat fakte nuk janë kontestuar asnjëherë nga ana e Prokurorisë, mbrojtësve apo të akuzuarve.

### **Rikualifikimi i veprave penale nga ana e Gjykatës**

Pas analizimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, akuzës dhe përshkrimit faktit në pikën I dhe II të dispozitivit të akuzës, Gjykata gjenë se përshkrimi faktik dhe veprimet inkriminuese të përshkruara në dispozitivin e aktakuzës përmbushen elementet, figura, objekti si dhe veprimet e kryerjes së veprës penale Posedimi i i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së ku përcakton se *“Kryesi që kryen veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotrope ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”*

Sipas vlerësimit të Gjykatës, në rastin konkret **me qenë se nuk është përmbushur elementi kryesor** i veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPRK-së, e që është **“blerja me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes së substancës narkotike”**, atëherë nuk kemi të bëjmë me këtë vepër penale mirëpo me veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 i KPRK-së.

Si objekt me të cilin kryhet vepra penal Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 i KPRK-së, është **“substanca narkotike”**, ku si veprim i kryerjes së kësaj vepre penale është **“posedimi pa autorizim”**, i substancave narkotike e që në rastin konkret duke u bazuar në përshkrimin e pikës I dhe II të dispozitivit të aktakuzës, veprimeve inkriminuese të të akuzuarve dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, përputhen në tërësi elementet, figura, objekti si dhe veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale.

Gjykata me rastin e ricilësimit të veprës penale në pikën I dhe II të dispozitivit të Aktakuzës e ka bërë në par.2 të nenit 275 të KPRK-së, pasi që substanca narkotike e gjetur tek i akuzuari B.P ka peshë neto 1.67 gram, ndërsa substanca narkotike e gjetur tek i akuzuari Sh.S ka peshë neto 0.71 gram, dhe një cigare me peshë neto 0.78 gram (sipas Raportit të Ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me nr. ref.AKF/2014-1381/2014-1114 i dt.08.05.2014), që do të thotë se nuk e tejkalon peshën prej 3 gram, dhe po për të akuzuarin nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale për vepra penale sipas të dhënave nga **Raporti i Shkrimorës së kësaj Gjykate numër PN.nr.4082/2020, konstatohet se nga të dhënat që posedon Gjykata përveq lëndës P.nr.102/14, që zhvillohet ndaj të akuzuarve B.P dhe Sh.S nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale të kësaj natyre përveq për të akuzuarin Sh.S për veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 327 par.1 të KPRK-së lënda me numër rendor P.nr.745/2020.**

Sipas vlerësimit të Gjykatës, në rastin konkret kemi përshkrimin faktik të kryerjes së veprës penale dhe veprimet inkrimiuues të të akuzuarve, mirëpo jo në përputhje (ndërlidhje) me veprën penale adekuate duke pasur parasysh elementet, figurën, objektin dhe veprimet e kryerjes së veprës penale.

Pra me qenë se në çështjen penale konkrete kemi të bëjmë konkretisht me **“posedimin pa autorizim të substancës narkotike”**, duke u mbështetur në aktakuzë dhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata vlerëson se ricilësimi i tillë juridik është adekuat me veprën penale *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 i KPRK-së*.

### **Parashkrimi i veprave penale të rikualifikuara**

Pas rikualifikimit të veprave penale për të akuzuarit në veprën penale Posedimi i i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.2 të KPRK-së, ku për këtë veprë penale parashihet dënimi me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, e duke u bazuar në nenin 106 par.1 i KPRK-së, ku përcakton se “ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e më poshtme” nën par.1.6 përcakton se “dy (2) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose dënim me gjobë”, e lidhur me nenin 107 par.8 të KPRK-së ku përcakton se “ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parshkrimit”, e që në rastin konkret ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale pasi që koha e kryerjes së veprës penale që dyshohen të akuzuarit është dt.13.02.2014, dhe parashkrimi absolut ka rrjedhur që nga dt.13.02.2018, andaj Gjykata ndaj të akuzuarve në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.3 të KPP-së merr aktgjykim refuzues.

Në rastin konkret prokuroria, nuk kishte siguruar prova, që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte do të mund të vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen si në aktakuzë, mbi bazën e të gjitha këtyre rrethanave të konstatuara si më lart, në arsyet e dhëna, gjykata vlerëson se janë në përputhshmëri me vendimin e marrë si në dispozitivin e këtij aktgjykim refuzues për të akuzuarit, të konstatuara nga provat e administruara gjatë shqyrtimi gjyqësor andaj gjykata i vlerësoj edhe me rastin e marrjes së aktgjykimit, duke sqaruar rrethanat lidhur me çështjen, duke krijuar një bindje të bazuar të gjykatës me rastin e marrjes së vendimit, se nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale që akuzohen sipas aktakuzës mirëpo veprat penale të rikualifikuara nga ana e gjykatës dhe në bazë të këtyre rrethanave dhe provave të administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, Gjykata ka vlerësuar se është vlerësuar prëtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprat penale të rikualifikuara nga ana e gjykatës dhe duke pasur mbështetje në dispozitat ligjore dhe atë neni 3 par.2 të Kodit të Procedurës Penal një parim kryesor i procedurës penale ”In dubio pro reo” ku përcakton se “mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penale interpretohen në favor të të akuzuarit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”, e nga këto Gjykata ka krijuar bindjen e plotë ka marrë Aktgjykim Refuzues në mbështetje të nenit 363 par 1 nën par.1.3 të KPP-së.

Gjykata, vlerëson se provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk provojnë asnjë nga faktet të cilat janë potencuar në aktakuzë, Gjykata nga të gjitha arsyet që ka dhënë si më lart, arrin në përfundim se në veprimet e akuzuarve nuk konsumohen elementet e veprave penale dhe se provat e paraqitura nga ana e Prokurorisë nuk kanë ndërlidhshmëri me përshkrimet e pretenduara të veprimeve inkrimiuuese të të akuzuarve dhe provat janë kundërargumente për vet aktakuzën dhe nuk mund të vërtetojnë përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit me veprimet e tyre kanë kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK-së

konkretisht veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPK-së.

### **Korigjimi dhe plotësim i dispozitivit të akuzës në përshkrimin faktik në bazë të gjendjes faktike**

Në dispozitivin e Aktakuzës është bërë përshkrimi faktik si nën pikën I e II, të veprave penale për të cilat të akuzuarit janë dyshuar, përshkrimi është kontradiktor dhe kundërthënës siç konstatohet në përshkrimin e aktakuzës, Gjykata në dispozitivin e aktgjykimit ka bërë përshkrimin faktik si nën pikën I dhe II të veprave penale si dhe rikualifikimin për shkak se gjatë administrimit të provave trupi gjykues ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarve nuk janë vërtetuar elementet për veprën penale që akuzohen si në aktakuzë, me arsyet e theksuar si më lart, dhe se korigjim dhe plotësim është bërë në përmbajtjen e fakteve dhe rrethanave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të cilat përbejnë elementet e veprës penale, përshkrimi i fakteve dhe i rrethanave që nënkupton përshkrimin faktik të veprës, që në dispozitiv të Aktgjykimit pas administrimit të provave janë bërë plotësime në përshkrim faktik i nevojshëm në raport me veprën penale dhe nuk është bërë marrja mekanike e plotë e tekstit të Aktakuzës, kjo duke pasur mbështetje edhe në Komentarin e Kodit të Procedurës Penale faqe 848, në komentim të nenit 365 par.1 nën par.1.1 të KPP-së, ku citohet “Edhe pse sa i përket përshkrimit faktik të veprës duhet të ekzistojë identiteti ndërmjet aktakuzës dhe aktgjykimit, kjo nuk do të thotë se aktgjykimi duhet ta marrë në mënyrë mekanike dhe tekstualisht tekstin nga aktakuza”, kjo i referohet përshkrimit faktik duke mos cenuar në asnjë mënyrë identitetin objektiv pasi që është përcaktuar kualifikimi ligjor për veprën penale me të cilën akuzohen të akuzuarit dhe atë subjektiv pasi që në dispozitiv të aktakuzës është i vërtetuar identiteti i palës së akuzuar.

### **Lidhur me konfiskimin e sendeve**

Prokuroria në Aktakuzë në pikën III ka propozuar që të akuzuarve të j'u konfiskohet substanca narkotike. Gjykata në mbështetje të nenit 275 par.3 të KPRK-së ku përcakton se “substancat narkotike, substancat psikotrope ose analoge konfiskohen” e lidhur me neni 282 par.1 ku përcakton se “pasuria që është qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit, pa marrë parasysh gjetjet e gjyqtarit të vetëm gjykues ose trupit gjykues lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit” lidhur me par.2 nën par.2.4 të KPP-së ku përcakton se “kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga neni 272-280 të Kodit Penal”, nga i akuzuari **Sh.S ka konfiskuar** substancën narkotike Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me pesh neto 0.71 gram, dhe një cigare me përmbajtje Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me pesh neto 0.78 gram, nga i akuzuari **B.P ka konfiskuar** substancën narkotike Kanabis (Marihuanë) që përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me pesh neto 1.67 gram, (sipas Raportit të Ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë me nr. ref.AKF/2014-1381/2014-1114 i dt.08.05.2014), substancat narkotike pas plotëfuqishmërisësë këtij aktgjykimi të shkatërrohen.

### **Shpenzimet e procedurës**

Të akuzuarit lirohen nga shpenzimet e procedurës duke u bazuar në nenin 454 par.1 të KPP-së, ku përcakton se “kur pushohet procedura penale apo kurr merret aktgjykimi me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza gjykata me aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 450 par.2 nën par.2.1 të, deri 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të akuzuarit dhe kompezimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore”.

Gjykata nga arsyet e cekura si më lart duke u bazuar në nenin 363 par.1 nën par.1.3 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti për Krime të Renda**  
**P.nr.102/14 dt.05.01.2021**

**Procesmbajtësi**  
**Endrit Hajrizaj**

**Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari**  
**Bekim Veliqi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.